

Progetto co- finanziato da



UNIONE
EUROPEA



*Prefettura - UTG
di Alessandria*



MINISTERO
DELL'INTERNO

L'opuscolo informativo “ITALIA: ISTRUZIONI PER L’USO” è stato realizzato dall'Istituto per la storia della resistenza e della società contemporanea in provincia di Alessandria “Carlo Gilardenghi”, nell'ambito del Progetto “Da straniero a cittadino”, della Prefettura - UTG di Alessandria, finanziato dal Fondo Europeo per l'integrazione di cittadini di paesi terzi – FEI Prefetture “Capacity building 2012.

Traduzione in lingua albanese realizzata da Gentiana Tepshi

**Fondo europeo per l'integrazione di cittadini di paesi terzi
Progetto “Da straniero a cittadino”**

ITALI: UDHEZIME PER PERDORIMIN



**Istituto per la storia della resistenza e
della società contemporanea
in provincia di Alessandria
“Carlo Gilardenghi”**

Mireserdhet ne Itali!

Neni 1

Italia eshte nje Republike demokratike, e bazuar ne punen. Sovraniteti i perket popullit, qe e ushtron ate ne format dhe brenda kufijve te Kushtetutes.

Neni 3

Te gjithë shtetasit kane dinjitet shoqeror te njejte dhe jane te barabarte perpara ligjit, pa dallim seksi, race, gjuhe, feje, mendimi politik, kushtesh vetjake e shoqerore. Eshte detyre e Republikës hequja e pengesave te karakterit ekonomik e shoqeror, te cilat, duke kufizuar ne praktike lirine dhe barazine e shtetasve, ndalojne zhvillimin e plote te personalitetit njerezor dhe pjesemarrjen efektive te te gjithë punonjesve ne organizimin politik, ekonomik e shoqeror te Vendit.

Neni 11

Italia e hedh poshte luften si instrument cenimi te lirise se popujve te tjere dhe si mjet zgjidhjeje te mosmareveshjeve nderkombetare, pranon, ne kushte barazie me shtetet e tjera, kufizime te sovranitetit per aq sa jane te nevojshme per nje rend qe te siguroje paqen dhe drejtesine ndermjet Kombeve; ajo incurajon dhe favorizon organizatat nderkombetare qe kane kete qellim.

Keto ligje jane disa nga parimet themelore ne te cilen bazohet **Kushtetuta e Republikës Italiane**.

Republika eshte zgjedhur nga populli italian me nje referendum me 2 qershor 1946 dhe per kete arsye kjo dite ne Itali eshte feste kombetare. Ne kete dite votuan per here te pare edhe grate. Nje dite tjeter feste kombetare ne Itali eshte edhe 25 prilli, dita e clirimit nga fashizmi dhe nazizmi.

Eshte e ndaluar c'do forme violence brenda dhe jashte familjes.

Arsimimi eshte nje e drejte themelore per formimin e personit dhe integrimin e tij ne shoqeri, per kete te gjithë femijet duhet te respektojne detyrimin shkollor ,sic eshte shpjeguar me lart. Eshte nje detyrim i prinderve te dergojne femijet e tyre ne shkolle. Shkolla eshte vendi ku femijet dhe te rinjte, me origjine italiane apo te huaj, mesojne se bashku te ndertojne te ardhmen e shoqerise.

Puna eshte nje e drejte e c'do qytetari dhe duhet te kryhet duke zbatuar ligjin. Eshte e ndaluar puna ne te zeze dhe c'do forme diskriminimi dhe shfrytezimi.

Racizmi dhe ksenofobia ,ne te gjithë format e tyre .kundershtohen me force.

Te gjithë kane te drejte te marrin kurat mjeksore te domosdoshme ne strukturat publike. Jane te ndaluara te gjitha format e gjymtimit te trupit, perjashtuar rastet per arsye mjeksore.

Italia eshte kunder luftes dhe eshte e angazhuar ne nivel internacional per zgjidhjen paqesore te konflikteve.

Ne Itali nuk praktikohet as dhuna dhe as denimi me vdekje, ashtu si ne te gjithë vendet e tjera evropiane. Evropa dhe Italia po luftojne qe te hiqen edhe ne pjesen tjeter te botes, sepse kudo respektohen te drejtat e njeriut dhe format demokratike te shtetit , qe garantojne pjesmarrjen e te gjithëve ne jeten politike.

Ne Itali pjesmarrja ne jeten civile realizohet edhe nepermjet shoqatave. Shume persona, italiane apo te huaj, jane te angazhuar ne shoqata qe merren me vullnetarizem ne fusha te ndryshme si :shendetsi sociale, kulture, sport etj .Me emigracionin kane lindur shume shoqeri qe kane si qellim t'u mesojne dhe percjellin te tjereve gjuhen dhe zakonet e vendit te origjines, te favorizojne shkembimin ndermjet italianeve dhe te huajve, por edhe te huajve ndermjet tyre me prejardhje te ndryshme . Te jetosh ne Itali do te thote te marresh pjese ne nje feste, ne nje koncert, ose ne nje konference kulturore.....ndoshta me nje nderprerje per ndonje embelsire te shijshme pse jo edhe interkulturore!

Duke firmosur marreveshjen e integritit qytetari i huaj angazhohet per te respektuar Letren e vlerave te nenshtetsise dhe te integritit. Po c'fare eshte ky dokument dhe c'fare permban.? Letra e vlerave lind per te permbledhur dhe per t'ju bere te qarte te gjithëve, parimet themelore ne te cilen bazohet jeta civile ne Itali, parime qe dalin nga Kushtetuta e Republikes dhe nga Letrat evropiane dhe internacionale mbi te drejtat e njeriut, dhe vecanerisht mbi problemet qe mund te lindin nga bashkejetesa e kulturave te ndryshme.



Vlerat kryesore te bashkejeteses civile ne Itali jane liria, barazia dhe respektimi i dinjitetit te c'do personi. Per kete arsye Italia parashikon mbeshtetjen e personave ne nevoje, ne vecanti grate dhe te miturit, viktimat e deskriminimit dhe te persekutimit, si psh ata qe kerkojne azil politik, te ardhur nga vende qe jane ne lufte ose vende nen diktature. Italia mbeshtet edhe ata persone qe jane ne gjendje te keqe ekonomike, sepse te gjithë kane te drejte per nje jete dinjitoze. Barazi do te thote te gjithë, burra e gra, italiane apo te huaj te kene te njejtat te drejta dhe detyrime. Burri dhe grua jane te barabarte perpara ligjit, dhe kane te drejta te njejta brenda familjes, ne shoqeri dhe ne vendin e punes. Te gjithë personat qe jetojne ne Itali kane te drejte te shprehin fene e tyre ne kultura te ndryshme, dhe respektimin e te tjereve. Shteti eshte laik dhe te gjithë fete e tjera jane te lira perpara ligjit. C'do simbol fetar respektohet, ashtu si edhe c'do forme veshjeje, por mbulimi i fytyres ne vende publike eshte e ndaluar, sepse kjo nuk lejon identifikimin e personit.

Ne Rome , kryeqyteti i Italise, eshte firmosur ne 1957 “Traktati i Romes” qe krijoi Komunitetin Ekonomik Evropian, sot Bashkimi Evropian. Ne fund te vitit 2013 shtetet anetare te Bashkimit Evropian ishin 28.



Nga gjysma e dyte e vitit 1800 deri ne Luften e Pare Boterore dhe ne dhjetvjecaret e ardhshem deri ne Luften e Dyte Boterore Italia ka qene nje vend emigrant, si jashte dhe brenda vendit, nga Jugu ne Veri, dhe nga Lindja ne Perendim. Nga vitet '90 te shekullit te kaluar eshte bere destinacion per shume emigrant te ardhur nga shtete te ndryshme te botes.



Qytetari i huaj qe hyn ne Itali per here te pare firmos **Marreveshjen e Integritimit** . Behet fjale per nje marreveshje ndermjet qytetarit te huaj me moshe mbi 16 vjec dhe Shtetit Italian, duke u bazuar t mbi nje parim te Bashkimit Evropian , e perkrahur edhe nga Italia.Integritimi eshte nje proces pershtatjeje reciproke ,qe perfshin si qytetarin e huaj, ashtu edhe qytetarin e shtetit evropian.Kjo do te thote qe qytetaret e huaj duhet te marrin pjese ne jeten publike dhe kane te drejta dhe detyrime ndaj shtetit Italian. Ne te njejten kohe shoqeria qe i mirepret duhet t'i garantoje qytetareve te huaj qasje ne njohuri te gjuhes italiane , te ligjeve,dhe te funksionimit te sherbimeve.

Respektimi i kesaj marreveshjeje valutohet c'do 2 vjet, brenda te cilit qytetari i huaj duhet te demostroje :

- njohje te mjaftueshme te te folurit te gjuhes italiane
- njohje te mjaftueshme te parimeve themelore te Kushtetutes dhe organizimit te Shtetit
- njohje e mjaftueshme e jetes civile , ne fushen e shendetsise,te arsimit, sherbimeve sociale,punes dhe detyrimeve fiskale.
- Permbushja e detyrimit shkollor per femijet minorene.

Shtetet qe permbahen ne karten e vlerave te shtetesise dhe integritimit. Shteti ve falas, ne dispozicion te qytetareve te huaj ,mjete per te arritur keto rezultate : kurse ne Qendrat Territoriale te Perhershme , vidio dhe fletushka te perkthyer ne gjuhe te huaja.

Kush don te dije me shume per marreveshjen e integritimit mund te konsultohet ne faqen e internetit <http://www.interno.gov.it> del Ministero dell'Interno, ku do te gjeni informacione te perkthyer ne 19 gjuhe .

Ne Itali te gjithë femijet duhet te shkojne ne shkolle. Duke filluar nga mosha 6 deri ne 16 vjec shkolla eshte e detyrueshme dhe falas. Shume femije fillojne kopshtin qe ne moshen 2/ 3 vjecare dhe edhe per kete grupmoshe shkolla eshte falas.N.q.s te dy prinderit punojne , femijet mund te frekuentojne cerdhen duke filluar qe ne moshen 3 muajshe .Mbas detyrimit shkollor ,mosha mbi 16 vjec, te rinjte mund te frekuentojne shkollen e mesme publike gratis , duke zgjedhur drejtime ne baze te aftesive te tyre te pershtatshme , deri sa te marrin nje diplome , shume e rendesishme ne fushen e punes. Ndersa Universiteti kerkon nje pagese ne baze te te ardhurave vjetore ,por studentet e mire dhe ato me te ardhura te uleta mund te perfitojne burse studimi.



Shkolla mund t'i drejtohet edhe te rriturve ,sepse te vazddosh te studimet e te informohesh eshte e rendesishme ne c'do moshe, per kete ekzistojne Qendrat Territoriale te Perhershme per edukimin e te rriturve ku eshte e mundur per qytetaret e huaj te mesojne gjuhen italiane dhe kulturen qytetare, duke frekuentuar kurse per te pasur diplomen e tete vjecares, per te mesuar gjuhe te ndryshme nga italishtja , informatike etj...

Keto jane sekretarite e Qendrave Territoriale te Perhershme ne province:Ne Alessandria - spalto Rovereto 63; Casale Monferrato – rruga Gonzaga 21; Acqui Terme – rruga Marengo 2. CTP i Acqui Terme ka dege te distakuara edhe ne Tortona, Ovada e Novi Ligure.

Per te marre te gjithë informacionet e duhura per regjistrimin ne shkolle te femijeve, te rinjve dhe te rriturve mund t'i drejtoheni sekretarise se shkolles publike me afer baneses suaj.

Ne Alessandria Spitali eshte ne rrugen Venezia 16 dhe ekziston edhe nje Spital Pediatrik , qe i dedikohet vetem kures se femijeve e qe ndodhet ne spalto Marengo 46. Ne rast nevoje ne keto sherbime mund te nderhyjne dhe ndermjetesit kulturor.

Grate shtatzena jane te mbrojtura e mund te drejtohen ne Konsultorin familiar ku do te ndiqen nga personeli i specializuar dhe nga ndermjetesit kulturore. Te gjitha analizat baze per grate shtatzena jane falas. Ne konsultor zhvillohen edhe aktivitetet per mbrojtjen e shendetit te grave , te cifteve, e te femijeve .Shume i rendesishem per femijet eshte edhe vaksinimi, ku prinderit jane te ftuar te dergojne femijet e tyre qe ne moshe te vogel per te parandaluar shume forma te semundjeve infektive.



Italia eshte e ndare ne 20 rajone , dhe keto te fundit te ndara ne provinca. Kryeqendra e Piemontes (nje rajon qe ndodhet ne veriperendim) eshte qyteti i Torinos. Alessandria eshte nje province e Piemontes, dhe pervec saj , si kryeqendra e provinces, ndodhen dhe qendra te tjera te rendesishme si : Casale, Acqui Terme, Novi Ligure, Ovada e Tortona. Serravalle Scrivia eshte nje qender e vogel banimi e provinces me perqindjen me te larte te qytetareve te huaj.

Marreveshja e integritit firmoset bashke me kerkesen per lejen e qendrimit me nje zgjatje jo me pak se nje vit. Ne momentin e firmes, marreveshja dorezohet ne dy kopje, nje per Prefektoren dhe nje tjetere per qytetarin e huaj, ne te cilen mund te zgjedhe gjuhen qe preferon, ndermjet atyre qe Ministria ka vene ne dispozicion.

Marreveshja e integritit firmoset ne Sportello Unico per l'Immigrazione te Prefektores ne rrugen Piacenza 31 – Alessandria (ne rast te hyrjes per pune ose bashkim familiar) ose ne Questure ne rrugen Lamarmora n.71 - Alessandria (ne rast te hyrjes per vete punesim , kohezion familiar, ose motive te tjera).

Prefektura dhe Kuestura jane pikat e para te referimit ne territor per qytetaret e huaj, ketu ne fakt behen praktikat per leshimin dhe rinovimin e lejes se qendrimit, per te kerkuar bashkimin familiar ose nenshtetsine italiane.

Sapo te paiseni me lejen e qendrimit eshte e rendesishme t'i drejtoheni Komunes ne te cilen jetoni per t'u regjistruar ne regjistrin e banoreve.Me pas qytetari i huaj mund te kryeje praktika te ndryshme te rendesishme si: Karta e identifikimit , shpallja e gjendjes se familjes, certifikata personale etj...

Ne disa komuna te provinces eksiston nje sherbim i ndermjetesimit kulturor, me persona eksperte qe flasin gjuhet me te perdorura te emigranteve.



Ne Alessandria sportelli per te huajt ndodhet ne Komune , ne piacen Libertà 1. Ne Casale Monferrato Komuna ndodhet ne rrugen Mameli 10, ndersa Sportelli per qytetaret e - Agjensia Familjare ndodhet ne rrugen Martiri di Nassirya 8. Ne Novi Ligure Komuna ndodhet ne rrugen Giacometti 22, ne Tortona in rrugen Alessandria 62, ne Valenza ne rrugen Pellizzari 2, ne Ovada ne rrugen Torino 69 dhe ne Serravalle Scrivia ne rrugen Berthoud 49. Eksiston dhe nje regjister i rendesishem ku mund te regjistroheni : ajo e Qendrave te Punesimit e dobishme per te hyre ne boten e punes. Ne Alessandria.ndodhet ne rrugen Cavour 17, ne Tortona ne rrugen Marsala 22, ne Novi Ligure ine rrugen Oneto 29, ne Acqui Terme ne rrugen Crispi 15 , ne Casale M.to ne rrugen Magnocavallo 11/13, ne Ovada ne rrugen Pietro Nenni 12/16, ne Valenza ne rrugen 9 febbraio 16.

Ne c'do komune , ekziston edhe sherbimi social, qe ndihmon personat dhe familjet ne nevoje ne raste te: veshtiresive ekonomike, personave me aftesi te kufizuar , keqtrajtimeve.

Ligjet europiane dhe italiane mbrojne shendetin e te gjithe qytetareve. Qytetaret e huaj te pajisur me leje qendrimi mund te regjistrohen ne Sherbimin Shendetesor Nazional dhe mund te zgjedhin mjekun e familjes dhe pediatrin per femijet e tyre. Sherbimet shendetsore te ofruara nga autoritetet shendetsore lokale parashikojne pagesen e nje tiket, ne baze te te ardhurave vjetore, dhe n.q.s. keto te ardhura jane te ulta mund te aplikohet per mos pagim.

Per t'u regjistruar ne Sherbimin Shendetesor Nazional dhe per te zgjedhur mjekun e familjes duhet te drejtoheni ne qarkun ASL AL: Alessandria - rruga Pacinotti 38; Acqui Terme - rruga Alessandria 1; Casale Monferrato - rruga Palestro 41; Novi Ligure - rruga Papa Giovanni XXIII; Ovada -rruga XXV aprile 22; Tortona - rruga Milazzo 1; Valenza - rruga Santuario 67/69.

Ndihma e shpejte eshte e hapur 24 mbi 24, per urgjencat. Numri i telefonit per te kerkuar ndihmen e shpejte me ambulanc eshte 118. Kur nje person arrin ne urgjence pritjet nga nje infermiere e specializuar qe mbledh informacion mbi problemin shendetsor dhe shenon nje kod me ngjyre ne baze te urgjences: e kuqe do te thote urgjente, e verdhe tregon mesatare kritike , jeshile pak kritike ,dhe e bardhe nuk eshte urgjente.



Eshte shume e rendesishme qe keto sherbime te perdoren vetem per urgjenza reale . Kjo behet per mos te krijuar rralle , pritje te panevojshme dhe mbi te gjitha t'i sherbehet ne menyre sa me te shpejte rasteve te renda dhe me rrezik jete .Per te gjithe rastet e tjera shendetsore eshte mjeku i familjes , pediatri, ose sherbime te tjera shendetsore.Shume i rendesishem eshte edhe parandalimi , te kesh nje stil jetese te shendetshme (ushqim natyral, te mos pish duhan ,te mos konsumosh shume pije alkoloke , te besh levizje) dhe te besh kontrollet mjeksore te parashikuara (psh per grate pap testin dhe mammografine). E gjithe kjo sherben per te evituar shume semundje , ose te kapen ne fazen fillestare ,kur mundesite per sherim jane me te medha.